

Editorial/

Pengesa në rrugën e thirrjes islame

Nga Muhamed Adil Faris



Përplasja mes të vërtetës dhe të pavërtetës, midis së mirës dhe të keqes është pa aq e vjetër sa dhe vetë njerëzimi. I pari konflikt ndodhi mes dy bijve të Ademit a.s.. Por konflikti nuk mbaroi këtu, por do të vazhdojë derisa Allahut të trashëgojë tokën dhe gjithçka ka mbi të. Për aq kohë sa situata është e tillë, duhet domozodo që e vërteta të ketë mbështetësit e vet që ta mbrojnë nga të paudhët, nga padrejtësia dhe armiqësia e tyre. Kjo përplasje ka edhe pasojat e veta të shumta. Si rrjedhojë njerëzit e të vërtetës duhet të jenë të përgatitur për të përballuar pasojat e këtij konflikti, të durojnë vështirësitë dhe sprovat që vijnë si pasojë e besimit të tyre tek e vërteta dhe për mbrojtjen që ata i sigurojnë asaj. Vështirëse mund të besohet që e vërteta të qëndrojnë në këmbë dhe parimet e mirësisë të jetojnë gjatë nëse nuk do të ketë njerëz që të mbajnë mbi supë vështirësitë e kësaj rruge të mirësisë, njerëz që ta ndihmojnë dhe të paguajnë çmimin për të, për shkak se ndjekësit e të kotës nuk do t'i lenë të qetë mbështetësit e të vërtetës dhe mirësisë, do të shpenzojnë gjithçka kanë për t'i mënjeluar nga e vërteta dhe për t'i lënduar. Pra duhet domozodo që të ekzistojnë disa njerëz që janë përgatitur për të mbajtur amanetin, për të

duruar vështirësitë dhe sprovat, që të sakrifikojnë gjithçka për besimin dhe bindjen e tyre. Sprova është një ligj i pandryshueshëm në rrugën e thirrjes islame që në lashtësi. Për një të vërtetë të tillë ka folur Allahu a.xh. kur thotë: **“A mendojnë njerëzit se do të lihen të thonë “ne besojmë” dhe të mos sprovohen? Ne vërtetë i kemi vënë në provë ata që kanë jetuar para tyre, në mënyrë që Allahu të bëjë me dije ata që kanë qenë të vërtetë dhe të bëjë me dije se kush ishin gënjeshtarët.”** (Ankebut, 1-3)

Vështirësitë dhe sprovat nuk i ndodhin vetëm besimtarëve, por ato i ndodhin edhe njerëzve jobesimtar dhe të prishur, por mundësia e ekzpozimit të muslimanit ndaj tyre është më e madhe, me qëllimin e pastrimit të radhëve, për të vënë në provë forcën e besimit dhe për ta ngritur atë lartë në shkallë. Medito pak rreth fjalës së Allahut të Lartësuar: **“Nëse ju ndieni dhembje, atëherë edhe ata (jobesimtarët) ndiejnë dhembje, por ju shpresoni prej Allahut atë që ata nuk e shpresojnë.”** (En-Nisa, 104). I dërguari i Allahut (a.s.) është pyetur se cilët njerëz do të sprovohen më shumë dhe është përgjigjur: **“Profetët, pastaj ata që u ngajnë më shumë atyre.”** Ahmedi dhe Buhariu. Njerëzit ndahen në disa kategori kur

bëhet fjalë për përballjen me me vështirësitë. Disa prej tyre tregohen të dobët, madje e lëshojnë rrugën e të vërtetës në këmbim të jetës së mirë dhe riskut. Disa të tjerë frikësohen edhe më tepër dhe si pasojë sulmojnë njerëzit e ditur duke i akuzuar si të paditur dhe duke gjërmuar gabimet e tyre. Kjo metodë –sipas tij– mund të fshehë të vërtetën, të kamuflojë frikën dhe dobësinë e besimit të tij, duke e bërë të shfaqet para njerëzve si njeri i urtë dhe i zgjuar dhe jo frikacak dhe i mundur. Disa të tjerë që qëndrojnë në krahun tjetër nuk mposhten nga furtunat dhe as nuk përkulen nga sprovat. Ata e çajnë rrugën e tyre pa marrë parasysh se çfarë i lëndon ata në rrugën e Allahut. Lëndimi atyre u duket i ëmbël dhe i marrin lehtë vështirësitë. Të tillë njerëz

kanë qenë shumicë në kohën e sahabeve, qëndrimet dhe sakrificat e të cilëve kanë qenë shkak i fitores së të vërtetës dhe mbijetesës së saj. Kurani Famëlartë e ka përmendur këtë kategori njerëzish duke thënë: **“Ka prej besimtarëve disa burra që e mbajtën premtimin që i kishin dhënë Allahut. Ata nuk u treguan të dobët dhe as nuk u përkulën. Me të vërtetë Allahu i do durimtarët.”** (Ali Imran, 146).

Ekziston edhe një kategori tjetër njerëzish, të cilët herë forcohen dhe herë dobësohen. Të tillë njerëz, edhe pse ka mirësi në punët e tyre, nuk mund të mbështetesh tek ata, sepse mund ta lëshojnë thirrjen e tyre në rrugën e Allahut në kohët më të vështira. Atëherë prej cilës kategori dëshiron të jesh?

Fq.3/ Aktualitet/ Emërtimi “Hoxhë” midis titullit të merituar dhe etiketimit abuziv

Nga hoxhë Xhemis Stafa

Fq.4/ Ekonomi/ Fenomeni i emërtimit të kamatës së ndaluar

Nga Shejh Muhamed el Munexhid

Fq.5/ Kalendari islam

Nga hoxhë dr. Gazmir Nabolli

Fetva/

Filmat dhe lojërat me përmbajtje shirku dhe magjie

Pyetje:

Vitet e fundit studiot e mëdha kinematografike, të filmave për fëmijë, kanë prodhuar filma vizatimor që përmbajnë skena magjie apo shirku. Mund të përmend këtu Winx Club, Yugi... etj. Cili është gjykimi i Islamit në lidhje me shikimin e këtyre filmave? Po për lojërat elektronike për fëmijë, që përmbajnë skena magjie, dhune, kryqe, krijesa të mbinatyrshe. A duhet t'i lejojmë fëmijët tanë, të luajnë me këto lojëra?

Përgjigje:

Kjo pyetje ka lidhje me një fenomen më të gjerë kulturor të ditëve të sotme dhe është reflektim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i disa rrymave me natyrë teozofike, spiritualiste, magjike, pagane, New Age etj. Edhe pse jetojmë në një botë moderne, ku mendohej se shkenca dhe zhvillimi teknologjik do të zhdukte nevojën e njeriut për besimet fetare, sot krahas rigjallërimit të feve tradicionale, në shumë vende të botës, përballemi edhe me një rigjallërim të idhujtarisë dhe paganizmit të dikurshëm, por me forma dhe përmbajtje deri diku të re. Këto rishfaqje të neopaganizmit gjenden më të përhapura në Perëndim, dhe prej andej ato shpërndahen në mbarë botën, jo vetëm në formën e tyre origjinale si ide dhe besime, por edhe nëpërmjet fenomeneve kulturore të ndryshme, siç janë muzika, filmat, piktura, arti etj.

Kulturat dhe qytetërimet pagane, ashtu si edhe dikur, i japin një rëndësi të theksuar imazhit. Figurat, simbolet e idhujve dhe të perëndive në këto kultura, ashtu si edhe sot në kohët moderne, dominonin ngado jetën e një idhujtari, sepse ai në çdo moment kërkonte që të shoqërohej nga mbrojtja dhe përkujdesja e këtyre hyjnive të rreme, që ai i besonte për të vërteta, ai ashtu si dhe shumë njerëz të sotëm, ishte i dashuruar pas objekteve që përfaqësojnë këto imazhe. Në ditët e sotme gjen një përhapje tejet masive të kësaj neo-

idhujtarie, të kamufluar nën petkun e asaj që quhet art pamor. Kështu p.sh. mjaft filma vizatimorë për fëmijë, paraqesin personazhe imagjinare, qofshin këto të marrë nga mitologjia apo edhe të sajuar, personazhe këto që kanë fuqi mbinatyrore, që me anë të magjisë apo mjeteve të tjera, fitojnë aftësi për të bërë gjëra, që në besimin politeist zotat mund t'i bënin dhe që në realitet, vetëm Krijuesi i ka të mundshme. Këto filma jo vetëm që japin një pamje të pasaktë të realitetit, por ato edukojnë brezin e ri me frymën se njeriu është Zoti i kësaj bote, pasi në to, kurrkund nuk duket roli i Zotit të vërtetë. Ky fenomen shfaqet edhe më i sofistikuar në filmat artistikë për të rritur, ku imagjinata fantastiko-shkencore e producentëve të kinemasë, i bën ato të duken si realitet i mundshëm njerëzor, gjëra që në fakt vetëm Zoti i ka në dorë... Në të gjitha këto materiale, vihet theksi te fuqitë mbinatyrore të njeriut, ndërsa roli apo edhe vetë ekzistenca e Zotit, nuk duket asgjekund. A nuk është kjo një formë e re e propagandimit të idhujtarisë, pavarësisht pamjes së saj?

Muslimani e ka detyrë të besojë se Allahu është Krijuesi dhe Zoti i kësaj bote dhe vetëm Ai ka fuqi të sjellë dëmin dhe dobinë. Vetëm Ai është i Gjithëdijshëm dhe i Plotfuqishëm për çdo gjë dhe vetëm Atij i përkasin atributet hyjnore. Ai e sjell fatin, mbarësinë, suksesin, shpëtimin, shërimin, lumturinë...etj, vetëm Ai e ruan njeriun nga efektet e magjisë, fatkeqësitë, sëmundjet dhe dëmet e ndryshme. Ky është besimi i vërtetë islam, që ndryshe quhet edhe Teuhid, njësimi i Allahut në besim dhe adhurim.

Nisur nga kjo që thamë, të gjitha ato filma ose lojëra elektronike që përmbajnë të tilla skena magjie, idhujtarie etj, apo dhune dhe simbolika joislame, nuk lejohet të shihen, në veçanti nga ana e fëmijëve dhe brezi i ri. Këtu futen edhe lojërat me letra apo karta të ndryshme si YU-GI-OH, Bakugan, Winx etj, të përhapura shumë mes fëmijëve, karta të cilat përmbajnë simbole pagane, fuqi mbinatyrore imagjinare, gjoja lugetër që ngrihen nga varri dhe bëjnë veprime të ndryshme, që nuk i bëjnë dot të tjerët etj, si këto. Të gjitha këto gjëra, janë elementë të cilët lenë ndikim negativ në formimin e fëmijëve, ndaj dhe janë të ndaluara. Veç kësaj përmbajtja e këtyre filmave ose lojërave cenon hapur Teuhidin, monoteizmin islam.

Profeti Muhamed (alejhissalatu uesselam) një ditë i thoshte Abdullah ibn Abasit, kur ai ishte ende fëmijë:

"O djalosh...! Kur të lutesh, lutju Allahut dhe kur të kërkosh ndihmë kërkoi vetëm Allahut! Dije se, nëse të gjithë njerëzit grumbullohen që të të sjellin ty një dobi, ata nuk mund të bëjnë asgjë veç asaj që të ka caktuar Allahu. Dhe nëse njerëzit mblidhen të të bëjnë ty një dëm, nuk mund të të bëjnë dot asgjë veç asaj që ka caktuar Allahu!" (Transmetoi Tirmidhiu).

Kjo është edukata që duhet t'u japim fëmijëve tanë dhe t'i largojmë ata nga çdo gjë që e cënon Teuhidin. Përgjegjësia kryesore në këtë rast bie mbi prindërit e fëmijëve, të cilët në shumicën e rasteve tregohen neglizhent dhe nuk përkujdesen për edukimin dhe formimin moral dhe fetar të fëmijëve të tyre, në mënyrën e duhur dhe të vazhdueshme. Pikërisht kjo neglizhencë bën që fëmijët të përmbushin nevojat e tyre të moshës me lojëra dhe filma të cilat lenë ndikim negativ tek ta gjatë gjithë jetës, ku edhe mund të bëhen shkak të humbasin gradualisht identitetin e tyre islam.

Allahu e di më së miri!

Komisioni i Pyetje & Përgjigjeve pranë LSHH

Festimi i festës së Halloween-it

Pyetje:

Ditë më parë në vendin tonë, krahas shumë zhvillimeve kishim edhe një festë e cila kohës së fundit pothuajse është bërë tradicionale. Fjala është për festën e Halloween-it. Kudo nëpër Shqipëri pati organizime për të festuar një festë të tillë. Si konsiderohet nga Islami festimi i një feste të tillë dhe a lejohet që fëmijët tanë të marrin pjesë në festime të tilla që mund të organizohen nëpër shkolla apo kopshte?

Përgjigje:

Halloween është një festë me origjinë pagane. Në Skocinë e vjetër dikur mendohej se ishte pikërisht nata e 31 Tetorit, kur nuk kishte kufi mes botës së të gjallëve dhe të vdekurve. Dita e 31 e muajit Tetor (kur dhe festohet Halloween) shënon fundin e vitit të keltëve dhe besohet të jetë dita kur shpirtrat e atyre që kanë vdekur vitin e mëparshëm do të kthehen për të zënë vend në trupin e një të gjalli. Pikërisht për këtë arsye, njerëzit veshin kostume të frikshme për t'i trembur ata. Po ashtu sipas

versioneve të ndryshme apo nga ajo që ka mbetur nga legjendat apo mitet e vjetra, në natën e Samhain, keltët besonin se shpirtrat e njerëzve që kishin vdekur vitin e kaluar do të ecnin në mesin e të gjallëve. Kështu, fshatarët vinin ushqim dhe ëmbëlsira të qetësonin shpirtrat e tyre. Edhe pse Halloween ka origjinë pagane, emri i saj rrjedh nga pushimet e të krishterëve "All Hallows Eve", Dita e Shenjtorëve, apo mbrëmja para Ditës së të Gjithë Shenjtorëve (1 Nëntor). Pushimet që përkonin me këtë datë, në fakt ishin një përpjekje e radhës për të zhveshur krishterimin nga ritet e ndryshme pagane. Në Shqipëri kjo festë ka filluar të përhapet pas viteve 90-të. Muslimanët në fenë e tyre kanë vetëm dy festa vjetore, ato janë Fitër Bajrami, që vjen pas agjërimit të muajit Ramazan dhe Kurban Bajrami, që rikujton përkushtimin e Profetit Ibrahim ndaj Allahut. Kremtimi dhe përkujtimi i festave me origjinë pagane si dhe të gjitha festat që nuk lejohen fetarisht, janë të ndaluara të festohen, për arsye se Profeti (alejhissalatu uesselam) na ka ndaluar t'u përngajmë jomuslimanëve në të tilla gjëra. Një praktikë të tillë pas Profetit e kanë ndjekur edhe shokët e tij, si p.sh. Umer ibn Hatabi i cili i ndalonte muslimanët që të kremtonin Nevruzin, një festë perse kjo me origjinë pagane. Nuk lejohet po ashtu që fëmijët muslimanë të marrin pjesë në festime të tilla, kudo qofshin ato, në shkolla, kopshte, qendra kulturore apo në vende të veçanta ku rinia mblidhet enkas për të kujtuar të tilla festa. Për arsye se të tilla kremtime bën që fëmijët dhe të rinjtë të largohen nga natyrshmëria e pastër islame dhe të ndikohen nga rite, festime apo dhe besime të ndryshme të cilat mund të shpien deri në mosbesim. Edhe sikur festimi të jetë sa për t'u argëtuar ai nuk lejohet, sepse kështu fëmijët apo të rinjtë muslimanë tregojnë dobësi në karakterin e tyre dhe gradualisht shkojnë drejt humbjes së identitetit islam duke ngjasuar me jomuslimanët, në festat që u përkasin atyre. Në të njëjtën kohë duhet që muslimanët të kenë parasysh që edhe urimi i festave të tilla është i ndaluar. Andaj duhet që fëmijët muslimanë të pajisen me literaturën e nevojshme islame, të mësojnë parimet kryesore të fesë, të mësojnë historinë e Profetit Muhamed (alejhissalatu uesselam) dhe të praktikojnë rregullisht fenë e pastër islame për të qenë të ruajtur nga shfaqje të tilla.

Allahu e di më së miri.

Komisioni i Pyetje & Përgjigjeve pranë LSHH

Aktualitet/ EMËRTIMI "HOXHË" MIDIS TITULLIT TË MERITUAR DHE ETIKETIMIT ABUZIV

Nga hoxhë **Xhemis Stafa**



Para pak kohësh punonjësit e restaurimit të xhamisë së Nazareshës, (e cila daton në vitin 1599) gjetën një gur në formën e një çallme. Kjo më kujtoi një prej historive gazmore, por dhe domethënëse të një hoxhe, të cilit i bën një pyetje dhe ai modestisht iu përgjigj që nuk e dinte. Mirëpo pyetësi i çuditur nga përgjigja negative ia ktheu duke i thënë: -Si nuk e di, kur ti ke gjithë atë çallmë të madhe në kokë?! Hoxha i urtë atëherë i tha: Urdhëro çallmën time, vendose në kokë dhe mu përgjigj ti! Kjo për t'i treguar se nuk është çallma ajo që jep përgjigjet, por koka.

Duke marrë shkas nga ngjarja e mediatizuar nga emisioni "Me zemër të hapur" në televizionin News24 u ndjeva i indinjuar për keqpërdorimin e emrit "hoxhë" aty. Nuk dua të mendoj se ky emërtim është bërë qëllimisht. Në gjuhën tonë kjo fjalë është e njohur, mirëpo përdorimi i saj në mënyrën e gabuar dhe për personin e gabuar vjen për disa arsye:

Së pari për shkak të një të kaluarë të errët ateiste, ku ky emërtim ose klerikët që emërtoheshin me këtë emër bëheshin preh e një propagande denigruese. Figura e hoxhës ose klerikut fetar ishte në qendër të sulmeve nga më të ndryshme, duke filluar nga

shpifjet, shantazhet, akuzat, denigrimet, internimet dhe burgosjeve. Nuk na harrohet se si sistemi komunist dënoi me anë të shpifjeve një figurë të dashur për muslimanët shqiptar pas viteve 90', plakun e bardhë, hoxhën e nderuar hafiz Sabri Koci. Burgosja e tij u bë për shkak të shpifjeve të ulëta dhe për shkak se ai përfaqësonte një njeri me vlera të larta besimi. Ai u përballë me një sistem të sofistikuar shantazhi, i përligjur nga neni famëkeq i "agjitacionit dhe propagandës", nga akuzat e tilla si "armik i klasave" dhe

"armik i partisë", që përmbliidhen në një shprehje të vetme "armik i diktaturës". Deformimi mediatik i qëllimtë nga sistemi komunist i klerikut, me virtyte të larta fetare dhe intelektuale bëhej për të mbjellë në popull urrejtje, e shoqëruar kjo natyrisht nga maksima marksiste se "feja është opium për popullin" dhe "feja është prapambetje" etj. Mastrimet e diktaturës komuniste në fakt opiumizuan shoqërinë dhe lanë pasojë të mëdha te populli shqiptar, pasojë këto të cilat fatkeqësisht i trashëgojmë edhe sot e kësaj dite. Mbas 23 viteve demokraci populli shqiptar duket se është çliruar disi nga ndikimet ateiste. Liria fetare, hapja e xhamive, institucioneve fetare, botimi i librave të besimit etj, kanë ndikuar që njerëzit të rigjejnë natyrshmërinë e tyre të mohuar dhe të grabitur për shume vite me radhë. Sot njerëzit kanë kontakt më të shpeshtë me fenë, institucionet e saj, librat fetare dhe hoxhallarët e vërtetë. Ndërkohë vëmë re se ky kontakt u mungon shpesh qarqeve mediatike, redaksive, kryeredaktorëve, gazetarëve të medias së shkruar dhe vizive. Gazetarët, qoftë dhe për kulturë qytetare, duhet të kenë disa njohuri rreth feve, qytetërimeve dhe kulturave, me qëllim që të përçojnë te njerëzit njohuri dhe lajme të

sakta. Për t'u ardhur në ndihmë gazetarëve, kryeredaktorëve apo dhe opinionit publik, po japim një përkufizim të termit gjuhësor dhe fetar të fjalës hoxhë.

Fjala hoxhë vjen në gjuhën shqipe nga fjala turke "hoça" e cila origjinën e ka nga persishtja khauaxha, që do të thotë mjeshtër, zotëri. Nganjëherë në gjuhën e popullit mund hoxha përkufizohet si, njeriu që ka dituri dhe zgjuarsi dhe di t'i vendosë gjërat në vendin e duhur dhe në kohën e duhur, duke përdorur mënyrën e duhur. (kujtoni Nastradin hoxhën)

Në terminologjinë fetare titulli "Hoxhë" i atribuohet klerikut islam ose studiuesit të sinqertë fetar, i cili ka mbaruar një shkollë fetare islame dhe është i aftë të njohë dhe interpretojë parimet bazë të fesë dhe ka njohuri universale dhe të thella të jurisprudencës islame. Ai mund të jetë punonjës i një bashkësie islame, si imam, hatib... etj, por dhe mund ta performojë diturinë e tij fetare qoftë si një intelektual i pavarur, apo funksionar i ndonjë organizate islame të njohur. Pra në thelb titulli "hoxhë", i jepet personit tek i cili ndërthuren dy përkufizime, dhe si cilësi kryesore ka sinqeritetin dhe arsimimin fetar. Titulli "hoxhë" nuk mund t'i vendoset çdo njeriu, sepse ai nuk është thjesht etikete, që çdo kush mund ta varë në qafë, por ai është titull që të obligon përgjegjësi të mëdha, të cilat kërkojnë sinqeritet dhe aftësi për t'i mbajtur. Pikërisht asnjë prej nesh sot nuk thotë se, diktatori Enver Hoxha kishte titullin "hoxhë", meqë kishte këtë mbiemër, sepse ai ishte i kundërt i hoxhës. Po kështu ç'mund të themi për atë person që mashtron, është fallxhor ose magjistari? Sigurisht që të tillë njerëz janë në skajin tjetër të botës për të pasur këtë titull. Fatkeqësisht këtë titull, në periudhën e tranzicionit në Shqipëri, e kanë marrë edhe njerëz jo të meritueshëm, për shkak të mungesës së kuadrove fetare në vend. Nga kjo mungesë ka ardhur dhe keqkuptimi dhe mosnjohja nga njerëzit e personit që është hoxhë i vërtetë me titull dhe një mashtruesi, fallxhori, apo magjistari përfitues, matrapazi, i cili etiketohet gabimisht me titullin "hoxhë", por që ka abuzuar nga mos njohja e njerëzve që kanë në

çështjet e fesë. Shyqyr Zotit, sot kemi një bashkësi të madhe fetare islame, një institucion fetar, kemi imam dhe hoxhallarë të përgatitur në fushat e njohurive islame dhe është e patolerueshme për këdo që të quaj me titullin "hoxhë", një fallxhor, mashtrues, magjistari apo diktator që s'ka lidhje aspak as me sinqeritetin e as me arsimin akademik fetar islam. Për këtë gjë i bëj thirrje edhe Komunitetit Musliman, që për raste të tilla të prononcohet zyrtarisht, sikurse bëri në rastin e përmendur më lart. I bëj thirrje personave që i atribuojnë vetes këtë titull, që të heqin dorë prej mashtrimeve.

I bëj thirrje medias së shkruar dhe vizive, redaksive të gazetave, kryeredaktoreve, gazetarëve, drejtuesve të programeve dhe emisioneve televizive që të përdorin termat e duhur dhe fjalët e duhura, me qëllim që të mos përçojnë mesazhe të gabuara tek njerëzit, duke shkaktuar kështu dëme morale, që i shkojnë për shtat vetëm dezinformimit të periudhës komuniste.

I bëj thirrje edhe besimtareve që të sensibilizojnë të afërmit e tyre rreth këtij termi, me qëllim që shoqëria jonë të jetë në gjendje t'i identifikojë lehtësisht disa fenomene dhe persona negativë dhe të qe mos i ngatërrojë ata me staturën e vërtetë të hoxhës, në këtë periudhe postkomuniste.

Lidhja e Hoxhallarëve të Shqipërisë
رابطة أئمة البانيا
The Albanian Imam's League

www.lidhjahoxhallareve.com
Adresa: Rr. Teodor Keko (Unaza e Re)
P. Eglis, Kati III, Tirana-Albania
Mob1: 00 355 672304520
Mob2: 00 355 672753789
E-mail: lidhjahoxhallareve@yahoo.com

Ekonomi/ Fenomeni i emërtimit të kamatës së ndaluar me emra të tjerë

Nga Shejh Muhamed el Munexhid

Këtë parathënie e them duke marrë shkas prej disa vellezërve tim mi që merakosen për çështjet e fesë. Allahu i shpërbleftë, të cilët më treguan disa shkrime të publikuara nëpër gazeta jashtë vendit ku përmendeshin disa fetva që i kishin dhënë disa njerëz të humbur, të paktën në këtë çështje. Në këtë fetva - prej së cilës po shkëpus shkurtimisht disa arsytetime, argumente, deformime të teksteve fetare, disa thënie të dijetarë dhe të paraqitura sipas dëshirës së thënësit, thuhet: "Sipas asaj që përmendëm më parë...të gjitha transaksionet që kanë lidhje me certifikatat e investimit, apo të veprimeve të ngjashme me to, siç janë fondet e kursimit, lejohen fetarisht dhe fitimet e realizuara prej tyre janë gjithashtu hallall dhe të lejuara fetarisht, për shkak se këto janë mudarebe (bashkim i kapitalit me punën) - sipas tij- ose janë transaksione bashkëkohore që sjellin përfitime për individët dhe umetin dhe nuk përbëjnë shfrytëzim të njërës palë nga pala tjetër."

Më pas, duke u përpjekur t'i hapë rrugë kësaj metodologjie të ndaluar ai thotë: "Është punë e hajrit që njeriu t'i blejë këto certifikata dhe të pranojë të ardhurat që vijnë prej tyre - pra fitimet që jipen si rezultat i tyre."

Më pas autori shprehet plot mburrje:

"I kam propozuar autoriteteve përgjegjëse që të ndërmarrin masat e duhura".

Për çfarë? Për t'i quajtur fitimet që i jepen zotëruesve të certifikatave të investimit si "të ardhura nga investimi" ose "fitimi i investimit" dhe që ta fshijnë fjalë "fajde" ose interes, sepse këto fjalë tingëllojnë të lidhura me kamatën në mendjen e njerëzve.

Allahu i Lartësuar thotë: "**Pa të meta je Ti, kjo është një shpifje e madhe.**" (Nur, 16).

Në këtë mënyrë ai kërkon që tua bëjë njerëzve haramin hallall dhe propozon që kamata të quhet "fitimi i investimit" ose "të ardhura nga investimi", që t'i hutojë njerëzit dhe t'ia justifikojë atyre marrjen e shitesës. Ky nuk është i pari në këtë nismë, sepse çifutët janë të parët që e kanë nisur këtë gjë përpara tij, duke ua ndryshuar emrat gjërave në mënyrë që të ngatërrojnë njerëzit. I dërguari i Allahut (a.s.) na ka njoftuar se nga ky umet do të dalin njerëz që do ta pinë verën dhe do ta thërrasin atë jo me emrin e vet. Quaje sitë duash; verë, pije shpirtërore, alkool, Uiski, që të gjitha janë haram, sepse i dërguari i Allahut a.s.. thotë: "*Çdo gjë dehëse është verë dhe çdo verë është haram.*" Mund të shkosh ku të dëshirosh, majtas apo djathtas, ajo mbetet haram. Edhe në këtë rast themi: "Quaje si të dëshirosh; kamatë, interes, fitime, të

ardhura nga investimi etj." ajo mbetet e ndaluar, sepse është kamatë që është cilësuar e ndaluar në Kuran dhe në traditën profetike.

Më tej ai vazhdon: "*Përfshirja e njeriut në mudarebe (bashkim i kapitalit me punën) pa marrë përsipër asnjë humbje..*"

Vëllezër të dashur! Ne e dimë që përfshirja e individit në një biznes pa marrë përsipër asnjë humbje është e ndaluar. Këtë fjalë e themi ne dhe jo ai. Pra përfshirja e individit në një biznes me kushtin që të mos marrë përsipër asnjë humbje është e ndaluar. E çfarë mund të thuhet në rast se ai kushtëzon që të marrë një përqindje të caktuar fitimesh? Nëse përfshirja e njeriut në biznes me kusht që të mos marrë përsipër asnjë humbje është e ndaluar, atëherë si mund të përfshihet ai në një biznes në të cilin kushtëzon një përqindje të caktuar fitimi p.sh. 8 %, 10 %, 11 % etj? Kjo është edhe më e ndaluar. Si mund ta thotë diçka të tillë në fetvanë e tij duke u shprehur se përcaktimi i fitimit paraprakisht përbën mbrojtje të pasurisë?!

Në këtë mënyrë këta debatojnë rreth ajeteve të Allahut duke u përpjekur të çojnë njerëzit në humbje, pavarsisht justifikimeve kur shprehen se kamata ndodh mes dy palëve; mes të varfërit dhe të pasurit, apo ndodh atëherë kur ka shfrytëzim etj, ndërsa kur ndodh

mes të pasurit dhe të pasurit nuk ka asgjë të keqe. Kush e vendosi një rregull të tillë? Kush e bëri këtë përjashtim? A bëhet ky dallim në Kuranin famëlartë kur Allahu i Lartësuar thotë: "**Kijeni frikë Allahun dhe lëreni atë që ka mbetur nga kamata**" (Bekare, 278). A ka thënë Allahu lëreni kamatën që është mes të pasurve dhe të varfërve? Apo ajeti është i përgjithshëm dhe përfshin të pasurit me të pasurit, të varfërit me të varfërit dhe të pasurit me të varfërit? Ajeti është i përgjithshëm, por këta përpiqen ta nxjerrin jashtë rrethit të përgjithësimit, por ky ajet asnjë nuk mund të dalë, sepse ka zbritur prej të Urtit dhe të Gjithëdijshmit. Njerëzit e të kotës i shfrytëzojnë këto fetva të shtrembura në formën më të egër. Ata i shumëzojnë ato, i shtypin, i përhapin dhe i shpërndajnë. A ke hyrë ndonjëherë në një vend ku jepet dhe merret kamata ku të jetë shkruar: "**O ju që keni besuar! Frikësojuni Allahut dhe lëreni kamatën nëse jeni besimtarë. E nëse nuk e bëni, atëherë ju është shpallur luftë prej Allahut dhe të dërguarit të Vet**" (Bekare, 278-279). E ke hasur këtë ajet ndonjëherë në këto vende? Përkundrazi, në këto vende do të gesh të publikuara këto fetva të lira, të shtypura dhe të përhapura në mënyrë që njerëzit të shkojnë në humbje. Mjerë ata për dënimin që i pret prej Allahut!

Oaz i shpirtit/ ITINERARI I PENDIMIT

Nga hoxhë Valdet Kamberi

1- Falëndero Allahun që të bëri të kuptosh peshën e mëkateve ndaj Tij, të ka mundësuar të pendohesh, dhe nuk të mori shpirtin duke bërë mëkate.

2- Dije se ti e bërë të vdekur zemrën tënde në mëkate, por Allahu të ka ngjallur me dritën e udhëzimit.

3- A e din se Allahu është gëzuar për pendimin tënd, edhe pse Ai nuk ka nevojë për ty?

4- A e di se Allahu të ka premtuar se do t'i shndërrojë të këqiat e tua në punë të mira?

5- A e din se ti tani je nga ata që i do Allahu?

6- Bëhu i sinqertë në pendimin tënd dhe bindu se Allahu do ta pranojë atë. Kujto vrasësin e 100 personave.

7- Largohu nga shoqëria e keqe dhe mos u ul me ata, fshiji numrat e tyre dhe mënjano çdo gjë që të rikujton ata. Ata janë shigjeta helmuese.

8- Lutu tek Allahu që të forcojë në këtë rrugë.

9- Mos u mund nga ana e frikës, dije se Allahu falë atë që pendohet.

10- Largohu nga çdo mbeturinë e së kaluarës: fotografi, satelit, revista, numra dhe youtube.

11- Akuzo pendimin se ai nuk është i plotë dhe se ai ka mangësi e dobësi, ashtu që çdo herë të jesh i penduar.

12- Në fillim mund të gesh vështirësi në lënien e mëkateve, por

kush i frikësohet Allahut, Ai ia hapë rrugët.

13- Dijes e se shoqëria e përmirësimit nuk është shoqëri e pagabuar, por në mesin e tyre ka: të mire dhe të këqinj, të mangët e të shkëlqyer, kapu pas fesë e jo pas njerëzve.

14- Fillo të ndryshosh sjelljet e tua me familjen tënde që nga momenti i udhëzimit, ashtu që njerëzit të shohin shenjat e udhëzimit në ty.

15- Bëhu person me fillim serioz dhe me ambicje të larta.

16- Mundohu të ruash tekbinin fillestar me imamin dhe safin e parë.

17- Lexo biografinë e Muhamedit (a.s.) që të mësosh si ka qenë me Allahun dhe me njerëzit.

18- Disa njerëz mund të tallen me ty, si: të afërmit, shokët në shkollë e punë, njerëzit e lagjes. Por, mos ua vër veshin.

19- Vizito vendet që zbusin zemrën tënde, si: spitalet, shtëpitë e të moshuarve, varrezat, vendin ku pastrohen të vdekurit, etj.

20- Vizito faqet e dobishme islame në internet që kanë: ligjëratat islame, shkrime të ndryshme dhe pyetje e pergjigje rreth fesë.

21- Kujdesu të bësh adhurime vullnetare, si: agjërim, sadaka, lutje, dhikër, lexim të Kuranit, namaz nate, etj.

22- Plotësoje kohën tënde të lirë me aktivitete serioze, si: mësim të Kuranit përmendësh, kërkim të diturisë, ose me gjëra të lejuara, si: sport, ushtrime fizike, not, etj

23- Rregullo kohën dhe vendos listën e prioriteteve. Ji i vendosur t'i realizosh ato: të martohesh pas një viti, mësimin përmendësh të Kuranit pas një viti, mësim dhe ligjëratat çdo javë.

24- Bashkimi me shok të mirë që pajtohet me ty dhe të ndihmon.

25- Njohja e parëndësisë së dunjasë dhe shuarjen e saj dhe se ajo nuk vlen asgjë.

26- Kontakto më shpesh me ndonjë hoxhë, thirrës, mësues që ai të jetë me të cilin këshillohesh për çështjet dhe problemet e tua të cilat mund të ndodhin ty pas pendimit.

27- Kujdes nga portat e shejtanit, cytjet dhe dyert e tij, mos paso hapat e tij.

28- Mos nxito të gjykos të tjerët: filani është qafir, bidatxhi, kronik, e të ngjajshme me këto shprehje, përveç pas vërtetimit dhe konsultimit me njerëzit që kanë dije dhe eksperience në këto çështje.

29- Nxito në ndalimin nga e keqja.

30- Ti ke nevojë për qëndrueshmëri deri në vdekje.

31- Le të shërbejë e kaluara jote si një mësim për ty në jetën tënde.

P.sh. tek: neglizhenca në shoqërimin me të këqijtë. Këta janë shkak për devijimin tënd, ndaj mos e neglizho këtë detaj.

32- Dije se mëkatet e tua të mëdha nuk janë pengesë që të jesh një burrë (grua) i madh pas udhëzimit, kush ka qenë Omeri-Allahu qoftë i kënaqur me të- para Islamit dhe pas.

33- Patjetër të dish kuptimin e saktë të pendimit, dije se lejohet të lozësh, të udhëtosh, të zbukurohesh, të tregtosh. Të gjitha këto në përputhje me rregullat islame.

34- Largimi nga vendet e joshjes dhe sprovës, sprovat janë dy lloje: a) epshe dhe vendet e tyre: tregje, qendra tregtare, kanale televizive. b) Dyshime, si: leximi i librave që kanë ide denigruese, shikimi i programeve dhe emisioneve që çënojnë besim tonë.

35- Shkruaj tregimin tënd të udhëzimit, ndoshta merr mësim ndokush.

36- Lexo tregimet e të penduarve dhe merr shembull nga pendimi i vërtetë i tyre.

37- Mos fillo në dawet-thirrje islame, përveç pasi të kesh njohur bazat e fesë dhe kushtet e saja.

38- Kërko dijen në rrugë të drejtë, sepse ajo është mjet për shpëtimin tënd pas Allahut të Lartësuar.

39- Mëso dispozitat që kanë të

KALENDARI ISLAM

Nga hoxhë dr. Gazmir Nabolli

Koha është krijim i Allahut. Allahu i Madhëruar kur krijoi diellin dhe hënën dhe caktoi lëvizjet e tyre u bë e mundshme ndarja dhe llogaritja e kohës siç thotë në Kuran:

“(Allahu) është ai i cili e bëri diellin ndriçim, hënën dritë dhe i përcaktoi asaj (hënës) rrathët që të dini të numëroni vitet dhe të bëni llogaritjen e tyre.” (Sure Junus: 5)

Dhe thotë gjithashtu: “Ne e bëmë natën dhe ditën mrekulli. E shuam (e bëmë të errët) mrekullinë e natës dhe e ndriçuam mrekullinë e ditës në mënyrë që të kërkoni prej mirësive të Zotit tuaj dhe të dini të numëroni vitet dhe të bëni llogaritjen e tyre.” (Sure El-Isra: 12).

Llogaritja e kohës është me rëndësi të madhe se me të janë lidhur ngushtë çdo gjë e jetës së njeriut: kohet e namazit, koha e agjërimit, koha e dhënies së zekatit, koha e haxhit, po ashtu edhe koha e punës, koha e ngrënies, koha e qetësimit, ditët e netët e begata, muajt e shenjtë, festat etj.

Koha sipas librit të Allahut ndahet në: ditë, javë, muaj dhe vite.

1- Ditët

Me krijimin e diellit u formua dita dhe u nda nga nata në mënyrë që të përhapet jeta në tokë dhe kjo është një prej mrekullive të Allahut, siç thotë Allahu në Kuran në ajetin e lartpërmendur:

“Ne e bëmë natën dhe ditën mrekulli. E shuam (e bëmë të errët) mrekullinë e natës dhe e ndriçuam mrekullinë e ditës në mënyrë që të kërkoni prej mirësive të Zotit tuaj.” (Sure El-Isra: 12).

“Ne e bëmë natën petk (për tu prehur nën mbulesën e saj) dhe ditën për të siguruar jetesën.” (Sure En-Nebe: 10-11).

Pra, ditën për të punuar dhe siguruar jetesën dhe kjo me prezencën e diellit kurse natën për t'u qetësuar dhe prehur dhe kjo me

(...vijon nga faqja nr. 4)

bëjnë me pendimin.

40- Llogarit se kjo ditë është dita e fundit për ty, çka kishe bërë në këtë rast.

41- Lexo Kuran dhe përmend Allahun shumë ashtu që zemra jote të mbushet me dashuri ndaj Allahut. 42- Nxito të martohesh ashtu që të ruash nderin tënd, sepse shumica e mëkateve janë nga ephset.

43- Çdo gjëje jepja vendin e saj dhe mbaj balancë.

44- Merr përgjigjet e fesë vetëm nga njerëzit kompetent.

45- Ndërro numrin e celularit, ashtu që mos të thërrasin shoqëria e kaluar, apo shoqet e të së kaluarës. 46- Tërhiqja vërejtjen njerëzve nga vendet e mëkateve.

47- Mëkatet e vetmisë janë shkak për lajthitje, ndërsa adhurimet në vetmi janë shkak për përforsim.

perëndimin e diellit dhe kalimin në errësirën e natës.

Nata me ditën të dyja së bashku përbëjnë një cikël të plotë që njihet me emrin ditë ose një cikël 24-orësh siç e quajmë ne sot.

Allahu në Kuran në shumë ajete kur përmend krijimin e natës dhe të ditës përmend të parën natën: “**Është Ai i cili krijoi natën, ditën, diellin dhe hënën. Që të gjitha ecin në një trajektore.**” (Sure El-Enbija: 33).

Kjo do të thotë se nata i paraprin ditës në kalendarin islam p.sh.: kur mbaron dita e fundit e Ramazanit dhe hyn nata dhe njerëzit presin te nesërmen për të festuar thonë: është natë bajrami. Kjo gjë thuhet për shkak se nata i paraprin ditës.

Nata fillon me perëndimin e diellit dhe mbaron me lindjen e agimit kurse dita fillon me lindjen e agimit dhe mbaron me perëndimin e diellit.

Allahu i Madhëruar thotë në Kuran ne lidhje me agjërimit: “**Hani e pini derisa te dallohet filli i bardhe nga filli i zi pastaj plotësojeni agjërimitin deri në hyrjen e natës**” (Sure El-bakara: 186).

Ky ajet tregon kufijtë e ditës dhe të natës:

1- Dallimi i fillit të bardhë nga i ziu është për qëllim dallimi bardhësisë se ditës nga e zeza e natës dhe ky është agimi sipas një hadithi të transmetuar nga Adij bin Hatim dhe duke qenë se agjërimit nuk bëhet veçse ditën atëherë agimi është pjesë e ditës. Këtë gjë e vërteton edhe një ajet tjetër ku Allahu thotë: “**Fale namazin në dy skajet e ditës dhe atë që vjen gjatë natës**” (Sure Hud: 11). Thotë imam Taberiu: ka ixhma mes dijetarëve se namazi i skajit të parë është namazi i sabahut. Pra agimi është skaji i parë i ditës i cili shënon gjithashtu edhe hyrjen e namazit të sabahut dhe fillimin e agjërimit.

2- Hyrja e natës është për qëllim perëndimi i diellit i cili shoqërohet me fillimin e errësirës siç thotë Profeti (a.s) në një hadith tjetër: “Kur

48- Mos shko tek shokët e vjetër që t'i thërrasësh në fe, përveç atëherë kur je forcuar shumë dhe në shoqërinë tënde të jetë një njeri që e kupton thirrjen.

49- Nëse ke mundësi bëj umre dhe haxh me shoqëri të shëndoshë.

50- Kujdes nga ekstremi i tepruar, andaj fillo me punë të pakta, sepse puna më e dashur tek Allahu është ajo që është e vazhdueshme edhe nëse është e paktë.

O I PENDUAR!

Pasi u pendove dhe braktise çdo gjë për Allah, asnjëherë mos ia jep shancin djallit të të mashtrojë dhe të kthehesh në atë rrugë. Allahu na ndihmoftë në rrugën e pendimit dhe na mbrojtë nga çdo gjë që na devijon nga ai. Amin!

të perëndojë dielli nga këtu duke bërë me shenje nga perëndimi dhe te fillojë nata nga këtu duke bërë me shenje nga lindja ka çelur agjëruesi”. Pra, perëndimi i diellit është skaji i dytë i ditës i cili shënon gjithashtu hyrjen e natës.

Nga këtu kuptojmë ndryshimin mes ditës në sheriatin islam dhe ditës në kalendarin astronomik.

Ndryshimi i parë: Në sheriatin islam e gjithë nata i paraprin ditës dhe se bashku me ditën në vijim përbëjnë një cikël të plotë pra një ditë 24 orëshe. Kurse në kalendarin astronomik nata e një dite 24 orëshe ndahet në dy pjesë: pjesa e parë nga perëndimi i diellit deri në 12 të natës, pjesa e dytë nga 12 e natës deri në lindje, ku pjesa e parë i përket ditës përpara dhe pjesa e dytë i përket ditës në vijim.

Ndryshimi i dytë: Pjesa e agimit deri në lindje në kalendarin tonë është pjesë e ditës kurse në kalendarin astronomik është pjesë e natës.

Kohët e adhurimit

Adhurimet e një ditë që kanë lidhje me kohën janë namazi dhe agjërimit, secila prej tyre ka një kohë të caktuar që nuk mund të kryhet veçse në të.

Namazet janë pesë: Sabahu, Yleja, Ikindia, Akshami dhe Jacia. Kohët e tyre janë të përcaktuara nga Allahu siç thotë ai vetë në Kuran: “**Namazi është për besimtarët është detyrë në kohën e caktuar**”. (Sure En-Nisa: 103).

Këto kohë të caktuara janë intervale kohore me fillim e me mbarim, ku çdo namaz gjatë kryerjes së tij nuk e merr gjithë intervalin tij kohor prandaj dhe quhet detyrë me kohë të zgjeruar dhe mund të kryhet ose në fillim, ose në mes, ose në fund të çdo intervalit përkatës.

Kjo gjë është mirësi prej Allahut të Madhëruar se namazi nga mënyra e kryerjes nuk mund të kryhet pa shkëputje nga puna dhe duke qenë se njeriu në këtë botë mund të preokupohet edhe me gjëra të tjera

prandaj dhe detyra e kryerjes së tij është bërë me interval kohor të gjerë.

SABAHU: Nga lindja e agimit deri në lindje të diellit siç thotë Profeti (a.s.): “Koha e sabahut, përderisa nuk ka lindur dielli.” E transmeton Muslimi.

YLEJA (DREKA): Kur dielli kalon zenitin deri kur hija e një objekti është sa gjatësia e tij siç thotë profeti a.s.: “Koha e drekës është kur dielli kalon zenitin deri kur hija e një burri të jetë sa gjatësia e tij.” E transmeton Muslimi.

Dielli kur lind hija e çdo objekti është nga perëndimi dhe kjo hije vjen duke u zvogëluar deri në zenit dhe pas zenitit dielli drejtohet nga perëndimi dhe hija kalon nga lindja. Pikërisht ky moment është fillimi i drekës dhe vazhdon deri sa gjatësia e hijes së një objekti që tashmë ka kaluar nga lindja të jetë sa gjatësia e objektit.

IKINDIA (PASDITJA): Kur hija e objektit është sa gjatësia e tij deri në perëndim të diellit.

Thotë Profeti (a.s.): “Koha e ikindisë, përderisa nuk është zverdhur dielli”. E transmeton Muslimi. Gjithashtu Profeti (a.s.) ka thënë: “Kush kap një rekat nga ikindia para se të perëndojë dielli, e ka kapur namazin.” E transmeton Muslimi.

AKSHAMI: Kur perëndon dielli deri në zhdukjen e shenjave të kuqe që lë dielli pas perëndimit.

Siç është transmetuar nga Profeti (a.s.): “Koha e akshamit përderisa nuk është zhdukur El-Shefek”. E transmeton Muslimi. Thotë Ibn Omeri: “El-Shefek është e kuqja (e perëndimit).”

JACIA (DARKA): Nga zhdukja e shenjave të kuqe deri në mesin e natës siç thotë Profeti (a.s.): “Koha e jacisë deri në gjysmën e natës.” E transmeton Muslimi.

Mesi i natës llogaritet duke parë intervalin kohor nga perëndimi i diellit deri në hyrjen e namazit të

(...vijon në faqen nr. 6)



MBLEDH ZEKATIN TUAJ

Për zekatin në lekë:
IBAN: AL 43 2051 6703 4163 29CL OTCL ALLB
Llogaria në lekë:
IBAN: AL 70 2051 6703 4163 29CL OTCL ALLA
Llogaria në Euro:
IBAN: AL 37 2051 6703 4163 29CL OTCF EURO
Llogaria në Dollarë:
IBAN: AL 81 2051 6703 4163 29CL OTCF USDA

Lidhja e Hoxhallarëve të Shqipërisë
Tel: 0672304520 /0672538334/048320160
BKT Banka Kombëtare Tregtare
Nr. i llogarisë : 52416329

sabahut, i cili përkon me lindjen e agimit. Gjysma e këtij intervali kohor është mesi i natës dhe ndryshon sipas stinëve të vitit.

Agjërimi është një lloj tjetër adhurimi që ka lidhje me kohën dhe ka fillimin dhe mbarimin e tij, fillon kur shfaqet agimi që është dhe hyrja e namazit të sabahut dhe mbaron kur përfundon dielli që është dhe hyrja e namazit të akshamit, por në ndryshim nga namazi që është detyrë e zgjeruar ai është detyrë e ngushtuar, sepse agjërimi e merr gjithë kohën e caktuar për kryerjen e tij. Agjërimi edhe pse është detyrë e ngushtuar, mirësia e Allahut nuk mungon as këtu, se nga mënyra se si kryhet nuk kërkon shikëputje nga punët e tjera të ditës dhe e bën atë të lehtë për besimtarin.

Kohët e ndaluara për adhurim gjatë ditës

Gjatë ditës ka tre kohë ku është ndaluar të falurit namaz dhe varrimi i të vdekurve siç transmetohet nga Ukbe bin Amir se ka thënë: *“Në tre kohë, na ka pas ndaluar profeti a.s.. të falemi dhe të varrosim të vdekurit tanë: kur lind dielli derisa të ngrihet në horizont, kur të jetë dielli në zenit (mesi i ditës) derisa të anojë (nga perëndimi) dhe kur dielli është duke perënduar.”* E transmeton Muslimi.

Shkaku i ndalimit në kohën e lindjes dhe të perëndimit është se dielli lind e perëndon mes brirëve të shejtanit dhe në atë kohë qafirët i bëjnë sexhde diellit, ndërsa për kohën e zenitit shkaku i ndalimit është ndezja e zjarrit të Xhehenemit siç transmetohet nga Amr bin Abese se e ka pyetur Profetin (a.s.) për namazin dhe i ka thënë: *“Fal namazin e sabahut dhe pastaj lëre faljen deri sa të lind dielli dhe të ngrihet se ai del del mes dy brirëve të shejtanit dhe në atë kohë i bëjnë sexhde atij (diellit) qafirët, pastaj falu se namazi është i prezantuar (nga melaiKET) derisa të ikë hija e shtizës, pastaj lëre namazin se në atë kohë ndizet zjarri i Xhehenemit, pastaj kur të dalë hija falu se namazi është i prezantuar (nga melaiKET) deri sa të falësh ikindinë pastaj lëre namazin derisa të perëndojë dielli sepse perëndon mes brirëve të shejtanit dhe në atë kohë i bëjnë sexhde atij qafirët.”* E transmeton Muslimi.

Pra, sipas këtyre haditheve namazi është i ndaluar para lidjes së diellit dhe para perëndimit të tij por ama është kohë e bereqetshme për përkujtimin e Allahut siç thotë Allahu në Kuran: **“Përkujtoje emrin e zotit tënd në mëngjes dhe në mbrëmje”** (Sure El-Insan, 25). Prandaj dhe profeti a.s.. e përkujtonte Allahun në këto dy kohë me dhikr të posaçëm.

Gjatë natës ka një orë të bereqetshme për lutje dhe namaz dhe që është një e treta e fundit e natës siç transmetohet nga Ebu Hurejra se Profeti (a.s.) ka thënë: *“Zbret Zoti ynë çdo natë në qiellin e dynjasë kur është një e treta e fundit e natës dhe thotë: Kush më lutet, ti përgjigjem? Kush më kërkon diçka, ti jap? Kush më kërkon falje, ta fal?”* E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

Kohët e punës

Dita në përgjithësi është krijuar



për të punuar -siç u përmend më lart- por gjatë ditës koha më e mirë për punë është mëngjesi i hershëm se profeti a.s.. është lutur për bereqet në këtë kohë siç transmetohet nga Sakhr El-Gamidi se Profeti (a.s.) ka thënë: *“O Allah jepi bereqet ymetit tim në mëngjesin e hershëm.”* Profeti a.s.. kur niste ndonjë çetë apo ushtri (për luftë) e niste në fillim të ditës. Sakhr ishte tregtar dhe e niste tregtinë në fillim të ditës dhe u pasurua duke iu shtuar pasuria. E transmeton Ebu Daudi dhe e saktëson sheikh Albani.

Kohët e qetësimit dhe të gjumit

Gjatë ditës koha më e mirë për të pushuar dhe qetësuar është mesi i ditës. Thotë Profeti (a.s.): *“Flini në drekë se shejtanët nuk flenë.”* E transmeton Ebu Nuajm dhe e saktëson sheikh Albani.

Ndërsa nata e gjitha është bërë për qetësim -siç u tha më lart- me përjashtim të kohës para se të falet namazi i jacisë dhe koha më e mirë për të fjetur gjatë saj është menjëherë pas jacisë, siç është transmetuar nga Ebu Berze El-Eslemij se Profeti (a.s.) *“E urrente gjumin para jacie dhe bisedat pas saj.”* Mutefekun alejhi.

Kohët e ushqimit

Paraditja dhe pasditja është koha ngrënies së ushqimit, madje në hadithe nuk përmenden më shumë se dy vakte ngrënie çka do të thotë se në kohën e Profeti (a.s.) nuk hanin më shumë se dy herë në ditë: një herë paradite në kohën e Duhasë dhe një herë pasdite afër akshamit.

Transmetohet nga Aisha radiallahu anha se ka thënë: *“Profeti (a.s.) vinte dhe na pyeste: Keni ndonjë gjë për El-Gada (vakti i paradites)? Ne, nëse i thoshim po, hante. Nëse i thoshim jo, thoshte: unë po agjëroj.”*

Transmetohet nga Enesi radiallahu anhu se Profeti (a.s.) ka thënë: *“Nëse vjen El-Asha (ushqimi i pasdites) dhe bëhet ikameti për namaz, filloni me ushqimin.”* E transmeton Muslimi.

Namazi i përmendur në këtë hadith është namazi i akshamit

Këto dy vakte i ka përmendur së bashku Aisha r.a. në një hadith tjetër ku thotë: *“I shtrydhja lëng profetit a.s.. në mëngjes dhe kur vinte pasditja e pinte për El-Asha (vakti i pasdites) dhe nëse tepronte gjë e derdhja. Pastaj i shtrydhja lëng natën dhe kur vinte mëngjesi e pinte për El-Gada (vakti i paradites). E laja enën dy herë në ditë.”* E transmeton Ebu Daudi dhe e saktëson sheikh Albani.

2- Java

Allahu i Madhëruar pas krijimit të ditëve i grupoi ato në javë ku një javë ka shtatë ditë. Caktimi i këtij numri ka lidhje me krijimin e qiejve dhe të tokës i cili u bë në gjashtë ditë dhe ditën shtatë Allahu u lartësua mbi arsh, siç thuhet në kuran: **“Zoti juaj është Allahu i cili krijoi qiejt dhe tokën në gjashtë ditë pastaj u lartësua mbi arsh”** (Sure Junus, 3).

Këto gjashtë ditë, katër prej tyre janë të krijimit të tokës dhe dy janë të krijimit të qiejve siç thotë Allahu i Madhëruar: **“Thuaju: ju po mohoni atë që ka krijuar tokën në dy ditë dhe po i bëni atij ortakë. Jo, ai është zoti i botëve. Ai bëri në të (tokë) male të palëkundshme nga ana sipërme e saj dhe derdhi mbi të bereqetin e tij dhe caktoi riskun e saj në katër ditë (katër ditë bashkë me dy ditët që u përmendën më lart). Shpjegim për këdo që pyet. Pastaj iu drejtua qiellit i cili ishte tym dhe u tha atij dhe tokës: hajdeni me dëshirë ose detyrim! Ata i thanë: po vijmë me dëshirë. Ai i ndau ata në shtatë qiej në dy ditë dhe çdo qielli i dha detyrën e tij dhe e zbukuruam qiellin e dynjasë me drita dhe për ta ruajtur. Ky është krijimi i plotfuqishmit të dijshtëm.”** (Sure Fussilet, 9-11).

Thotë sheikh el-Islam ibn Tejmije: *“Koha ndahet në: ditë, javë, muaj dhe vit. Për sa i përket ditës ajo dallohet me anë të shikimit, po kështu edhe muaji edhe viti me anë të numërimit në kalendarin hënor dhe me anë të shikimit në kalendarin diellor. Ndërsa për sa i përket javës nuk mund ti vihet ndonjë kufi as me anë të shqisave dhe as logjikës por kjo është njohur nga lajmet e profetëve se Allahu e ka krijuar botën në gjashtë ditë pastaj u lartësua mbi arsh, prandaj dhe Allahu i ka bërë çdo ymeti një ditë ku të mblidhen për të adhuruar Allahun një dhe të jetë kjo gjë shkak për regjistrimin e javës.”*

Tani lind pyetja se cila është dita e parë e javës?

Përgjigjja e kësaj pyetjeje ka lidhje me fillimin dhe mbarimin e krijimit. Ka dy mendime mes dijetarëve në lidhje me këtë çështje:

Mendimi i parë: Dita e parë e krijimit është dita e diel.

Ky mendim është mendimi i shumicës së dijetarëve mes tyre Imam Taberiu dhe e ka përkrahur sheikhu Islam Ibn Tejmije dhe mbështetet në disa fjalë të selefeve si Abdullah bin Selam, Abdullah bin Abas, Muxhahid etj. Le të përmendim mes tyre thënien e Abdullah bin Selam.

Thotë Abdullah bin Selam: *“Allahu i madhëruar e filloi krijimin dhe e krijoi tokën në ditën e diel dhe të hënë.”* E Transmeton Taberiu.

Mendimi i dytë: Dita e parë e krijimit është dita e shtune.

Ky mendim është i Muhamed ibn Is'hakut dijetarit të madh të historisë profetike dhe e ka përkrahur Imam Es-Suhejli dhe imam En-Neveviu siç duket në kapitujt ndarës që i ka bërë Sahih Muslimit dhe mbështetet në një hadith të transmetuar nga Ebu Hurejra.

Thotë Ebu Hurejra: *Më mori profeti a.s.. për dore dhe më tha: “E ka krijuar Allahu dheun ditën e shtune, i ka krijuar në të malet ditën e diel, i ka krijuar në të pemët ditën e hënë, e ka krijuar të keqen ditën e martë, e ka krijuar dritën ditën e mërkure, i ka shpërndarë në të kafshët ditën e enjte dhe e ka krijuar Ademën pas ikindisë ditën e xhuma në fund të krijimit, në orët e fundit të ditës së xhuma mes ikindisë dhe akshamit.”* E transmeton Muslimi.

Këtë hadith e kanë refuzuar dijetarët e mendimit të parë edhe pse e transmeton Muslimi për disa arsye:

1- E shpërndanë krijimin në shtatë ditë duke i përhurë të gjitha ditët e javës ndërkohë që Kurani e shpërndanë atë në gjashtë ditë.

2- Nuk përmend krijimin e qiejve.

3- Ky hadith në një prej rrugëve të tij të transmetimit nuk thuhet: nga Ebu Hurejra nga Profeti (a.s.) por thuhet: nga Ebu Hurejra nga Ka'ab El-Ehbar (një ish dijetar çifut që kishte pranuar Islamit) të cilin shpesh herë e pyeste Ebu Hurejra për lajme të përmendura në Teurat gjë që e bën hadithin të mos jetë i Profetit (a.s.) por i Kabit -Allahu e mëshiroftë!-

4- Kundërshton kuptimin e ditëve në gjuhën arabe:

Ditët e javës në arabisht dhe kuptimi i tyre

E Diel El-Ehad (e para)

E Hënë El-Ithnein (e dyta)

E Martë Eth-Thulatha (e treta)

E Mërkurë El-Erbia'a (e katërta)

E Enjte El-Khamis (e pesta)

E Xhuma (E Premte) El-Xhumuah (bashkimi)

E Shtunë Es-Sebt (ndërprerja)

Pra siç shihet nga kuptimet e emrave nga dita e diel deri në ditën e enjte, kanë kuptime numrash dhe në rast se do të ishte dita e shtunë dita e parë, nuk do të ishte dita e diel “El-Ehad” që do të thotë “E para” me këtë emër.

Vijon në numrin tjetër...

PROFETI ISA, I BIRI MERJEMES (A.S.) DHE MREKULLITË E TIJ

Nga hoxhë Emerim Koci

Falënderimi i takon Allahut, paqja dhe mëshira qofshin mbi të Dërguarin e Allahut (a.s.).

Te nd eruar besimtarë! Me rastin e të ashtëquajturave festat e krishtlindjes, po ju bëj një dhuratë modeste kushtuar profetit Isa (a.s.). Si lindi? Si u rrit? Si i ftoi hebrejtë në fenë e vërtetë, me çfarë mrekullish erdhi dhe si u ngrit në qiell?!

Isai (Jezusi) njihet ndryshe dhe me emrin Mesih. Thuhet Mesih sepse erdhi si fshirës i së kotës dhe përhapës i së drejtës. Gjithashtu thuhet se këtë emer ai e mori për shkak të udhëtimeve të shumta. Ai nuk kishte shtëpi dhe vend të tijin. Gjithashtu, thuhet se u quajt Mesih për shkak se kur lindi, nëna e tij Merjemja e leu me vaj.

Lindja e Isait (a.s.)

Allahu a.x.h. në Kuran thotë: **“Dhe trego (o Muhamed) në Libër për Merjemen, kur u largua nga familja e saj në një vend në lindje, duke e fshehur veten nga ata. – ajo jetonte në lindje të Jerusalemit, larg syve të njerëzve. Ajo nuk lejonte askënd ta vizitonte dhe nuk e vizitonte askënd. Të afërmit ia dërgonin ushqimin pranë derës dhe ajo e merrte më pas, ashtu siç merrte furnizim edhe nga vetë Zoti. Vetëm Zekerija a.s. kishte të drejtë ta vizitonte. Në moshën pesëmbëdhjetë vjeçare asaj i shfaqet Xhibrili a.s. në dhomën ku ishte izoluar dhe adhuronte Zotin - Ne i dërguam Shpirtin Tonë (Xhibrilin), i cili iu paraqit asaj si një njeri i plotë. – ishte një njeri i hijshëm dhe pa asnjë të metë - Ajo i tha: “Unë kërkoj të më mbrojtë i Gjithëmëshirshmi prej teje, nëse i frikësohesh Allahut – (nëse beson dhe i frikësohesh Zotit, mos më prek me dorë) - Ai tha: “Në të vërtetë, unë jam vetëm një i dërguar i Zotit tënd, që të të dhuroj ty një djalë të pastër.” Ajo tha: “Si mund të kem unë djalë, kur asnjë mashkull nuk më ka prekur e nuk jam as e pacipë?” Iu përgjigj: “Kështu është vullneti i Zotit! Zoti yt ka thënë: ‘Kjo për Mua është e lehtë. Ne do ta bëjmë atë shenjë për njerëzit dhe mëshirë nga ana Jonë’ dhe kjo është punë e kryer.” (Merjem, 16-21).**

Sipas transmetimeve të sakta, Xhibrili (a.s.) i fryu Merjemes tek e çara e jakës nga pjesa e kraharorit, frymë e cila i depërtoi brenda në mitër dhe në çast ajo mbeti shtatzënë. **“Ajo mbeti me barrë.”** (Merjem, 22)

Merjemja (a.s.) vazhdoi e mbyllur në faltoren e saj, larg syve të njerëzve, derisa filloi të ndjejë se ka ardhur koha të lindë. Atëherë ajo doli nga faltorja dhe eci një distancë të konsiderueshme, derisa mbërriti në Betlehem. **“..u tërhoq me të në një vend të largët.”** (Merjem, 22)

Pak para se të mbërrijë në Betlehem, asaj i fillojnë dhimbjet e lindjes. Ajo qëndron dhe mbështetet tek një trung i tharë palme aty pranë. Thotë Zoti në Kuran duke përshkruar këtë moment: **“Dhembjet e lindjes e detyruan atë që të shkonte te trungu i një palme.”**

Merjemja a.s. ishte shumë e frikësuar për këtë që po i ndodhte. Vallë si do të kthehej tek njerëzit e saj me një fëmijë?! Çfarë do të thoshin njerëzit kur ta shihnin? Fjalët e mëposhtme tregojnë më qartë frikën e saj nga skandali që mund t'i ndodhte - **Ajo tha: “Ah, sikur të kisha vdekur para kësaj (ngjarjeje) dhe të isha harruar krejt!”** (Merjem, 23).

Në një moment, ajo dëgjon një zë që e thërret nga poshtë. Disa mendojnë se ai zë ishte i djalit të saj të porsalindur Isait (a.s.), ndërsa disa të tjerë mendojnë se ishte zëri i Xhibrilit (a.s.), i cili buronte nga nëntoka **“Një zë e thirri nga poshtë: “Mos u pikëllo, se Zoti yt të ka bërë një burim uji poshtë teje!”** (Merjem, 24).

Me të hedhur shikimin poshtë, ajo dallooi një burim uji. Edhe kjo ishte një mrekulli që Zoti ia jepte për ta qetësuar. Një mrekulli tjetër në ato çaste ishte dhe vetë trungu i palmës, i cili siç thamë ishte i tharë, pa gjethe dhe fruta. Allahu a.x.h. thotë: **“Shkunde trungun e palmës, që të bien mbi ty hurma të freskëta! Ha, pi dhe qetësohu.”** (Merjem, 25-26).

Me ta shkundur trungun e palmës, menjëherë filluan të bien hurma (arabe) të freskëta. Këto mrekulli e qetësuan Merjemen (a.s.), pasi u sigurua se gjithçka që po i ndodhte ishte sipas një plani hyjnor. Zëri e urdhëroi që të mos flasë kur të kthehet tek njerëzit e saj, por me shenja t'ju tregojë se agjëron **“Nëse vëren ndonjë njeri, i thuaj: “Unë jam betuar në të Gjithëmëshirshmin se do të agjëroj, prandaj sot nuk do të flas me askënd.”** (Merjem, 26).

Pasi u çlodh dhe u qetësua, ajo u kthye tek njerëzit e saj me foshnjën në krahë **“Dhe u kthye te populli i vet, duke mbajtur fëmijën. Ata i thanë: “O Merjeme, ke bërë diçka të turpshme! O motra e Harunit!”** (Merjem, 27-28).

Thuhet që Merjemeja (a.s.) kishte një vëlla me emrin Harun, për këtë ata e thirrën si motra e Harunit. Kjo ceket dhe në një hadith të saktë, kur profeti Muhamed (a.s.) dërgon një nga shokët e tij tek të krishterët e Nexhranit. Ndër të tjera, ai u lexoi edhe ajetet e lartpërmendura. Kur të krishterët i dëgjuan, i thanë: **“Pse thonë se Merjemja ka qenë motra e Harunit, ndërkohë që Haruni ka jetuar në kohën e Musait?”** Sahabi kur u kthye tek Profeti a.s., ia përcolli këtë pyetje. Ai u përgjigj: **“Po a nuk e dinin se njerëzit e asaj kohe u vinin fëmijëve emrat e profetëve të mëparshëm?”** Pra, Haruni nuk ishte profeti, vëllai i Musait (a.s.). Një mendim tjetër lidhur me këtë është se ashtu si Haruni a.s. shquhej për adhurimin e shumë, edhe Merjemeja a.s. shquhej për diçka të tillë. Prej këtu, njerëzit e quanin motra e Harunit (a.s.).

“Babai yt nuk ka qenë njeri i keq, as nëna jote nuk ka qenë grua e shturur.” (Merjem, 28).

Si është e mundur që ti vajza e dy prindërve të ndershëm, të bësh një vepër të tillë?! Merjemja (a.s.) nuk u ktheu përgjigje, por u bënte me shenjë

drejt djalit që mbante në krahë: **“Ajo bëri me shenjë nga i biri. Ata thanë: “Si t'i flasim një fëmije te porsalindur foshnje?”** (Merjem, 29).

Njerëzit i kuptuan shenjat e saj, por nuk kuptonin si mund të flasin me një foshnje të porsalindur. Atëherë ndodh mrekullia tjetër, ku Isai (a.s.) i porsalindur flet. Të gjithë njerëzit filluan të dëgjojnë gojëhapur: **“Ai (Isai në djep) tha: “Unë jam rob i Allahut. Ai më ka dhënë Librin (Ungjillin), më ka bërë profet dhe më ka bërë të bekuar kudo që të jem. Ai më ka porositur që të falem e të jap zeqat sa të jem gjallë dhe të jem i mirë e i sjellshe me nënën time dhe nuk më ka bërë të ashpër dhe të padëgjueshëm. Le të jetë paqja e shpëtimit mbi mua, në ditën që kam lindur, në ditën që do të vdes dhe në ditën që do të ringjallem!”** (Merjem, 30-33).

Allahu i Lartësuar komenton më poshtë lidhur me këto fjalë: **“Ky është Isai, i biri i Merjemes. Kjo është fjala e vërtetë, për të cilën ata dyshojnë dhe diskutojnë. Allahu nuk ka nevojë të marrë dikë për bir. Qoftë i dliresuar Ai! Kur vendos diçka, Ai vetëm thotë për të “Bëhu!” dhe ajo bëhet. (Isai tha): “Vërtet, Allahu është Zoti im dhe Zoti juaj; andaj adhuroni vetëm Atë! Kjo është udha e drejtë.”** (Merjem, 34-36).

E tillë ishte lindja e profetit Isa (a.s.), i cili ishte vetëm profet dhe i dërguar i Zotit dhe asgjë më shumë. Duke u përgjigjur pretendimeve të krishterëve se Isai (a.s.) ishte bir i Zotit, Zoti thotë në Kuran: **“Pa dyshim, janë jobesimtarë ata që thonë: “Allahu është Mesihu, i biri i Merjemes!”**, sepse vetë Mesihu ka thënë: **“O bijtë e Izraelit, adhuroni Allahun, që është Zoti im dhe Zoti juaj! Sigurisht, atij që adhuroni tjetërkënd përveç Allahut, Allahu do t'ia ndalojë Xhenetin dhe strehim i tij do të jetë Zjarri. Për keqbërësit nuk ka ndihmës. Pa dyshim, janë jobesimtarë ata që thonë: “Allahu është njëri prej Trinisë!”** Nuk ka veçse një Zot të Vetëm të vërtetë! Nëse nuk heqin dorë nga ato që thonë, patjetër që jobesimtarët nga mesi i tyre do t'i godasë një dënim i dhembshëm. Përse ata nuk kthehen me pendesë tek Allahu e t'i kërkojnë falje Atij?! Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë! Mesihu, i biri i Merjemes, është vetëm një i dërguar. Edhe para tij kanë kaluar të dërguar. Nëna e tij përherë ka qenë e drejtë. Që të dy, hanin ushqim. – Kësisoj nuk mund të jetë zot, pasi Zoti i vërtetë nuk ka nevojë të ushqehet - Shiko si ua shpjegojmë atyre shpalljet tona dhe shih si largohen nga e Vërteta! Thuaju (o Muhamed): **“Si mundet vallë, që ju adhuroni në vend të Allahut, atë që nuk është në gjendje t'ju sjellë as dëm e as dobi, ndërkohë që Allahu dëgjon dhe di çdo gjë?”** (Maide, 72-76).

Zoti i vërtetë nuk ka nevojë për ndihmës dhe ortakë. Një ndër suret ku të krishterëve u jepet përgjigje mbi natyrën e vërtetë të Zotit – kësisoj

hedh poshtë dhe pretendimet e tyre mbi trininë – është surja Ihlas. Zoti në këtë sure thotë: **“Thuaj: “Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm! Allahu është Absoluti, të Cilit i përgjërohet gjithçka në amshim. Ai as nuk lind, as nuk është i lindur. Dhe askush nuk është i barabartë (a i krahasueshëm) me Atë!”** (Ihlas, 1-4).

Profeti Muhamed (a.s.) në një hadith të transmetuar nga imam Buhariu thotë: **“Askush nuk është më i durueshëm për një akuzë që ka dëgjuar, seç është Zoti. Atij i atribuojnë fëmijë, kurse Ai vazhdon t'i furnizojë dhe t'u falë shëndet.”**

Edhe pse foshnja ai porsalindur u foli ata nuk e besuan, madje e akuzuan për marrëdhënie jashtëmartesore. Që atëherë dhe deri ditët e sotme hebrenjtë e konsiderojnë Merjemen (a.s.) si grua të përdalë, ndërkohë që Isain (a.s.) e quajtën djalin e një gruaje të përdalë. Zoti i lartësuar mbi këtë fakt thotë: **“(I mallkuam ata) për shkak të mosbesimit të tyre (ndaj Isait a.s.) dhe për shkak të shpifjeve të mëdha që thanë kundër Merjemes.”** (Nisa, 156).

Nuk ka asgjë për t'u habitur nëse Zoti krijon dikë pa baba, ndërkohë që ka krijuar më parë Ademin (a.s.) pa baba dhe pa nënë. Këtë e përmend vetë Zoti në Kuran ku thotë: **“Rasti i Isait për Allahun është si rasti i Ademit që e krijoi prej baltës e pastaj i tha: “Bëhu!” - dhe ai u bë.”** (Al Imran, 59).

Të njejtat me këto shpifje, janë dhe ato të krishterëve se Isai (a.s.) ishte biri i Zotit: **“Ata të krishterët thonë: “I Gjithëmëshirshmi ka një bir”. Keni thënë diçka vërtetë të tmerrshme! Qiejt gati sa nuk copëtohen prej kësaj; Toka gati sa s'çahet e malet sa s'rrëzohen të thërrmuar, ngaqë ata i veshin një bir të Gjithëmëshirshmit. Kurrë nuk i shkon (madhështisë) të Gjithëmëshirshmit të ketë një bir. S'ka krijesë që gjendet në qiej dhe në Tokë e që të mos vijë si rob i perulur para të Gjithëmëshirshmit. Sigurisht që Ai e njeh mirë gjithsecilin prej tyre dhe i ka numëruar të gjithë saktësisht. Çdonjëri prej tyre, në Ditën e Kiametit, do të dalë fill i vetëm para Tij.”** (Merjem, 88-95).

Ai që ka krijuar qiejt dhe Tokën në formën më të përsosur, mos e ka të pamundur të krijojë një njeri me nënë dhe pa baba?!

“Ai është Krijuesi i qiejve dhe i Tokës! E si mund të ketë Ai fëmijë, ndërkohë që nuk ka bashkëshorte?! Ai ka krijuar çdo gjë dhe është i Gjithëdijshëm për çdo gjë.” (Maide, 101).

“Thuaju (o Muhamed): “Sikur i Gjithëmëshirshmi të kishte bir, Unë do të isha i pari që do ta adhuroja atë!” (Zuhruf, 81)

Zoti i Lartësuar e mohon kategorikisht mundësinë e të pasurit fëmijë. Ai deklaroi se sikur Isai (a.s.) të ishte djali i Tij, Ai do të ishte i pari që do e adhuronte atë.

Vijon në numrin tjetër...



Argjendari Hasani



Varëse
Vathë
Gjerdane
Unaza
Rrethe
Floriri dhe argjendi

- Bëjmë shpime veshësh
- Ngjitje dhe riparime



*** Të gjitha
14 karatë

Adresa: Rr. e Kavajës,
pranë Poliklinikës nr.9, Tiranë



PRODUKTE NATYRALE

Produkte bimore të cilësisë më të mirë nga vendet e Lindjes!

Produkte të firmës "Phenomenal", vaj të farës së zezë
Mjaltë me polen, mjaltë sidri, etj.
Hurma arabie të freskëta dhe ujë zemzemi
Kremra të ndryshëm të firmës "Orchid" dhe vajra bimore "Tact"
Shampo bimore "Touch Me" nga Tajlanda
Parfume vajore (3 ml) me aroma të llojlojshme
Parfume me mbushje të markave më të njohura europiane
Misvak dhe pastë dhëmbësh me misvak
Këna bimore 100% natyrale për flokë dhe për duar
Kohël bimor për sytë etj.

Adresa: Rr. e Kavajës,
rrugica përballë
xhamisë "Dine Hoxha", Tiranë
Cel: 0672812607 / 0672821589

www.produktenatyrale.com
Email: agimballa@hotmail.com

